GJETHI I KËPUTUR NË VJESHTË

Shtëpia botuese “Trend- Prishtinë
2018

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Redaktore:
Viktor Gjikolaj

Recensent:
Viktor Gjikolaj

Lektor:
Veli Veliu

Ballina:
Bashkim Alushi

GJETHI I KËPUTUR NË VJESHTË

Shtëpia botuese “Trend”- Prishtinë
2o17

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

I FILLIKATSHËM

Viktor Gjikolaj
Lezhë, më 11 shtator 2017

Me poezinë e poetit prizrenas ,Adem Zaplluzha jam njohur prej shumë motesh,por pjekjen e parë e shënojmë, në Takimin Poetik Kombëtarë,'' Ora e Muzës,Lissus,2016'', organizuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë dhe Klubi i Letrave të këtij qyteti, në 145 vjetorin e datëlindjes së poetik kombëtar,''Gjergj Fishta'.'
Kam ndjerë impresion të veçantë ,kur poeti nxori nga çanta 20 vëllimet e fundit me poezi. Nuk më kishte ndodh ndonjëherë ,që një autor të më sajdis me njëzetë veprat e tij. Adem Zaplluzha është i fillikatshëm në historinë e letërsisë shqipe e më gjerë.
Plot 159 vëllime poetike. Askush nga poetët e deritashëm nuk i ka botuar,madje nuk kemi asnjë dëshmi se mund të kenë, qoftë edhe në dorëshkrim një korpus të tillë gjigant.
Para do kohe, kur më dërgoi vëllimin e njëqind e pesëdhjetë e nëntë, për t' a këndua, duke më bërë njëherësh dhe ofertën

e të qenit redaktor e vlerësova konsideratën e mikut tim ,por pyeta veten: A thua mundem me marrë përsipër një përgjegjësi të tillë?!..

Vetëm me titujt e veprave të tij, mund të kompozojmë një poemë sepse në secilin titull gjen një varg me ngarkesa emocionale e nëntekste, që të japin dorë të shpalosh shumëçka nga stili dhe gjuha e autorit. Libri ,"Gjethi i këputur në vjeshtë", që i jepet në dorë lexuesit, është vazhdim kreativ i gjithë opusit poetik të autorit.

I kompozuar me tre cikle poetike,libri sjell realitetin tronditës të shoqërisë shqiptare në përgjithësi nëpërmjet një mesazhi universal:

Thërras turmën
Shurdhmemecët si gjithmonë lozin
Një valle të lashtë pagane
Më duket se nuk kam zë
Ose të tjerët
Kanë mbetur pa të shtatë shqisat

Kjo shurdhëri e lëndon zemrën e poetit , i cili si pjesë e avangardës thërret deri në kupë

të qiellit se koha po na len prapa e hapat e integrimit janë larg ritmit që kërkohet. Tani është koha për ta zënë trenin e agut të madh. Autori në këtë cikël shpalon edhe dukuri të pasluftës në Kosovë. Me tone drithëruese kërkon që mos të harrohet epika e ditëve të përgjakshme të qëndresës dhe luftës çlirimtare ,por të lartohet si flamur i madh për shqiptarinë.

Për të shtatën herë
Vritej po i njëjti njeri
Vritej vdekja
E cila aq krenarisht e përbuzte armikun

Dhe vaji i zambakëve nuk diti me heshtë
brigjeve të dhunuara të Lumëbardhit'
Pastaj:

I tërë qyteti me shamia të zeza
Vajtonte te kambana
Fatin e muranave që kurrë më nuk u ngritën

I dhemb në thellësi poetit të burrëruar mes dhimbjeve dhe flakëve në pritjet e gjata në të gjitha stinët e qytetit të tij

të lavdishëm,qytetit të kuvendeve,të shpresës për agimin e madh të bashkimit kombëtar. Vdekja nuk e tut(tremb),Ai nuk donë të vdes jo se i dhimbset gjaku, por se i duhet Dheut të tij.

Disa herë e pashë vdekjen me sy
Iu zgërdhesha dhe i thashë troç
Sonte s'dua të vdes i duhem atdheut tim

I duhet poeti Adem Zaplluzha, Prizrenit të tij ,vendit të vet si qytetar e si këngëtar, si ushtarë i vijës së parë në udhën e zhvillimit e integrimit .
Jeta vazhdon qytetit me kalldrëmet ilire, me dashurinë e madhe në zemër,me sy nga e ardhmja.

Dy nuse ktheheshin nga spitali
Me nga dy binjak në prehër
Kalldrëmet ilire pranë Shatërvanit
Shkëlqenin si asnjëherë më parë

I shkruar me gjuhë të pasur e me një stil të dallueshëm, produkti poetik i Zaplluzhës e pasuron traditën tonë, duke sjell në letërsinë shqipe një kontribut të fillikatshëm jo vetëm

nga masa, por edhe nga niveli artistik, motivet që sjell e mesazhet qytetare e humaniste që përcjell Autori me freskinë që na e sjell vjeshtën në këtë vëllim,dimrin e len larg në ftohtësinë e vet. Ai ndjehet i ri në vjeshtën e tij, larg muzgjeve e pranë Agut të madh të bashkimit. E na presim librin tjetër me këngë të reja për pranverën tonë.

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Cikli i parë
Në fundin e një fundi tragjik

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

DËPËRTOJ NËPËR RROPULLI MJEGULLASH

Kaloj mes përmes njerëzve
Eci si një fantazmë e tejdukshme
Nuk shoh njeri
As të tjerët nuk më shohin
Si një hije
Depërtoj nëpër rropulli mjegullash

Më duket se
I shëmbëllej një kufome të gjallë
Me mija njerëz
Hynë dhe dalin nga gjoksi im
Kjo zgërbonjë prej mishi
E paska aromën e barit të njomë

Thërras turmën
Shurdhmemecët si gjithmonë lozin
Një valle të lashtë pagane
Më duket se nuk kam zë
Ose të tjerët
Kanë mbetur pa të shtatë shqisat

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

E shiu i pranverës
U shëmbëllen litarëve të lagshtë
Rrebeshe stërkalash s’pushojnë
Ngjitem si kërmijtë nëpër muranat e vjetra
Thërras kot
Shurdhmemecët s’e ndalin vallen

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

DËNESIN DUART E KALBURA

Kohë e vranët pa shi
Shikoj diellin e humbur pas maleve
Një lehje e lashtë dhe misterioze
Nuk paska të ndalur sonte

Çdo gjë është duke lehur
S'pushojnë as mjegullat e hirta
Si nëpër faltore
Dënesin duart e kalbura

Diku në lagje qajnë nuset
Dielli nuk duket askund sot
Një re e zezë
Paska mbuluar gjysmën e qytetit

Kurse gjysma tjetër
Përpëlitet nën këmishën e përgjakur
Bari i ndrydhur ka humbur gjelbërimin
Kudo nëpër rrugë hinore të thyera

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

SI NJË MAKINË E PËRDORUR

Ajo kishte një pamje mistike
Dukej si era e ndrydhur
Nga bishtalecat e shkurtuara
Pikonte naftalina e tejdukshme

Gishtat e erës kishin mbetur peng
Mes fijeve të thyera të flokëve
Një djersë e akullt
Pikonte nga sytë e gështenjtë të mëngjesit

Disa pika gjaku paskan mbetur
Mbi gjelbërimin e turpëruar
Ajo parakalonte kalldrëmeve të lashtë
Si një hije e shpërdorur

Thonë se kishte marr udhë
Më duket se shkonte diku larg
Ecte mendje shthurur
Ishte nisur për diku askund

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

PRAPË NUK DINTE TË NDALEJ

Asnjëherë nuk e arriti cakun
I ngjante kërmillit
Në muret e lagshta të dhomës
Dy hapa para dhe po aq mbrapa

Ishte mësuar me zejen e fjalëve
Besonte aq shumë kashelashave
Sa që një ditë u shndërruan
Në një gjë e gjëzë asnjanëse

Prapë nuk dinte të ndalej
Sa herë që hipte majave
Po aq herë
Me një shpejtësi marramendëse binte në fund

Dikur vonë miku im kuptoi
Se fundi nuk kishte të sosur
Por ishte fillimi i trishtuar
I fundosjes në honin e pafund

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

DIKUR VONË LINDI FJALA

Atje në fund është fillimi
Po ai fillim
Ku lindi fjala
Kur njeriu nuk ishte njeri
Por një krijesë krejtësisht tjetër

Pas njëmijë ose dy mijë vjetëve
Mes gjetheve të fishkura
E gjeti vetveten kruspull
Fetus mbi një gjethe të kaltër
I cili aq shumë i ngjante fluturës

Kaluan edhe po aq vite
Së pari e mësoi ulërimën
Një lloj kënge
E cila ende këndohet sot
Siç këndohej në fillimin të gjenezës

Dikur vonë lindi
Në krahët e një fluture të verdhë
Fjala e cila ende sot jeton
Mes gjetheve dhe fluturave
Jeton si një nocion ende i pathënë

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

TË HY OSE TË DALË

Asgjë nuk paska mbetur
Mbi tavolinën e kujtimit
Vetëm dy gishta kripë
Dhe një copë djathi i mykur
Të cilin me vite nuk e prekën minjtë

Perdet e vjetruara
Valëviten si flamujt e grisur të luftës
Në një skutë të dhomës
Lagështia kishte zënë vend
Dhe lexonte një libër gjysmë të grisur

Mbi dyshemenë e vjetër
S'kisha ku të shkeli nga të çarat
Vallja mortore e kandrave
Kurrë nuk kishte pushuar këtu
Mbase ende dëgjohen daullet e luftës

Nuk jam në gjendje të vendos
Të hy ose të dalë
Nga këto pamje fantazmagorike
Një pasqyre përballë odës së burrave
Fsheh diçka të trishtueshme në brendinë e saj

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

QË SHKON PËRTEJ METAFORAVE

Para shumë e shumë viteve
I grisa biletat e blera
Nuk kam më se si të udhëtoj
Treni që kalonte nëpër lagjen time
Tani më nuk i dëgjohet zëri
Ka heshtur si varri

Biletat rrinin kot në sirtarin
Tim të vjetër
Mbrëmë i grisa
Me të gjitha kujtimet e mia
Ashtu të grisura i futa në stufë
Dhe pashë një flakë të kaltër

I njoftova miqtë
Po ashtu edha ata që ma donin vdekjen
Se unë nuk dua të vdes
As sivjet e as vitin tjetër
Nuk kam kohë për çmenduri të tilla
Le të vdesin ata që veç kanë vdekur

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Në fund të udhës
Mua më pret jeta e përtejme
Më presin engjëjt
Të cilëve kurrë nuk u besova
Më pret një rrugë e gjatë ajo e kaltra
Që shkon përtej metaforave

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

SONTE DO TË TROKASIM DERI NË MËNGJES

Nëse doni të mos trokas sonte
Nëpër xhamat e kujtesës
Mos flini
Gatuani një bukë të madhe të dashurisë
T'i ngopim të dashuruarit

Nuk është as vonë e as herët
Tani është koha
Ta zëmë trenin e mëngjesit
T'i zgjojmë nga gjumi të dashuruarit
Me kafshatën e ngrohtë të shpirtit

Ju thashë dhe ju them sërish
Mos i mbyllni dritaret
Lëreni të hapura edhe kujtimet
Sonte do të trokasim deri në mëngjes
Në mendjen dhe shpirtin e juaj

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

DËGJOHEJ AJO VALLE E LASHTË E ETJES

Zëri i thikës ose i sterrës
Ngjante me atë të klithmës
Më duket se ishte natë
Ndoshta gjaku m'i kishte mbuluar sytë
Por gjithsesi
Me qindra kufoma merrnin frymë si toka

Mbi varrezën e përbashkët
Dëgjohej dehja e topitur
Një zë që t'i shkatërronte shqisat
Nuk ishte zë bishe
Por ama nuk i shëmbëllente
As zërit të njeriut të shëndoshë

Kishim dhembje ndoshta edhe uri
Por më shumë ndjenin zjarrin e etjes
Në brendinë e rropullive
Dëgjohej si një rropamë teneqeje
Dëgjohej ajo valle e lashtë e etjes
Për jetë dhe ekzistencë

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

ASHTU SIÇ DI VETËM JETA TË MERR FRYMË NË LUFTË

Dhembja ishte më e thellë
Shumë më e thellë se çdo plagë tjetër
Një nënë kishte mbetur e gjymtuar
Me gjinj të këputura
Britma e saj dëgjohej si trishtimi
Dëgjohej shtatë bjeshkë larg varrezës masive
Si ta ushqej foshnjën e plagosur

Ajrin e ngrirë e ngrohnin
Breshëri të pandërprera plumbash
Ndoshta për të pestën herë
Ose për të shtatën
Vritej po i njëjti njeri
Vritej vdekja
E cila aq krenarisht e përbuzte armikun

Këtu një dënesje
Atje më poshtë një britmë
Vigmat e njerëzve s'kishin të ndalur
Ky lumë i vdekur prej kufomave
Merrte frymë si peshku
Merrte frymë
Ashtu siç di vetëm jeta të frymoj në luftë

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

MONOLOGU I NJË LUFTËTARI

Shikoj përreth varre të hapura
Shikoj aq sa mund të shikoj
Ky i vetmi sy
Që më ka mbetur në ballë

Një njeri i ngulur në kryq
Ma përkujton Krishtin
Ashtu si shiu imcak
Që mi përkujton lotët e ngrira të nënave

Pak më tutje shelgjishteve
Një kurm dukej si kërcu i djegur
Vetëm gjëma e tij tregonte
Se i shëmbëllente njeriut

Më duket se ky ushtar
Që po e kafshon të vdekurin
Qenka çmendur tërësisht
I paska kafshuar edhe gjymtyrët e veta

Një dru i kalbur merr frymë
Rrënjët e tij i përngjajnë oktopodit
Ky imazh asgjëje nuk i shëmbëllen
S’qenka as dru e as kurm njeri

ISHA VETËM UNË DHE FRIKA

Isha i vetëm
Mes një turme hienash
Pas shpine përroi i çmendur njerëzor
Para syve të mi
Një thikë e topitur ngulej
Në mishin e njomë të një fëmije

Isha vetëm unë dhe frika
Shikonim se si rritej turma
Në mua u zgjua bisha
Të cilën kurrë më nuk e zuri gjumi
Një prift i zi blozë
Bekonte njeriun me thikë të përgjakur

Isha i vetëm unë dhe uni im
I çmendur
U thashë në fytyrë
Ju jeni bisha të tërbuara
Qeshën duke ma afruar ta puthi kryqin
Qesha duke e përmjerrë metalin e ndryshkur

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

KUR EDHE KRYQIN MA VODHËN

Në oborrin tonë të vogël
Nën pemët e shartuara
Era i përtypte mjegullat
Dhe qante si kërthi

Nuk pata asnjë gurë
M'i vodhën edhe kujtimet
Si mund t'ua kthej borxhin
Atyre që s'pushuan së gjuajturi

Orë e çast ndryshonin stinët
Secili profet e bekonte flamurin e vet
Kurse atdheu im pa Zot s'dëgjohej gjallë
Ishte si një kurm shurdhmemec

Ende nuk mejnë së gjuajturi gurë
Gjuajnë dhe sërish i vjedhin
Çfarë të bëjë me frikën time
Kur s'mund t'i mbroj as gurtë e mi

Në oborrin tonë të vogël
Edhe mbrëmë gjuajtën me dru dhe gurë
Me çfarë t'ua kthej borxhin
Kur edhe kryqin ma vodhën

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

U DORËZUA KËSHTJELLA

Shkopinj të ndezur
Duken si qirinj
Në kurmin e gjymtuar të ditës
Sa pak dritë paska sot
Në sytë e përlotura të mjegullave

Nëpër ara breshëri bëri kërdi
Kokrra gurësh
Ranë mbi bukën e gatuar
Nën hijet e selvive
Një sofër e madhe qante si kalama

U dorëzua kështjella
Ra në dy gjunjë qyteti i Lumëbardhit
Vaji i zambakëve
Shtatë ditë e shtatë net
Nuk pushoi në brigjet e dhunuara

I humbëm edhe pemët
Një stuhi prej bore i shkuli rrënjët
I tërë qyteti me shamia të zeza
Vajtonte te kambana
Fatin e muranave që kurrë më nuk u ngritën

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

PASTAJ NDODHI NJË LUFTË E MADHE

Pakëz më ndryshe ishte shkruar bibla
Në fillim ishte dritë
Më pastaj u lëshua errësira
Nuk dihej më asnjëherë
Kur lindte dhe kur perëndonte dielli

Më kujtohet kur ikën dhentë
I lamë në përroin e fshatit
Dhe kurrë më nuk i kthyen nga kullosa
Deshëm t'i qethim atë ditë
Por ja që bariu iku diku larg

Pastaj ndodhi një luftë e madhe
Ato të vogla s'dua t'i përmendi
Ishin ngjarje të zakonshme
Në kohën e librit të shenjtë
Thonë se edhe luftërat ishin të shenjta

Më befasonin ngjarjet e një pas njëshme
Posa përfundonte një betejë e përgjakshme
Tjetra veç përgatitej me nxitim
Ndoshta njerëzit ishin të tillë
Nuk mund të jetonin pa u takuar me vdekjen

Prishtinë, 2 qershor 2017

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

ZGJOHU O ATË TË THËRRET ATDHEU I SFILITUR

O Atë disa lloje hajdutësh
Dhe kriminelësh
Keqpërdorën emrin tënd
Thonë se
Janë bijtë e djajve
Nuk kanë fe as Zot o Atë

Përfituesit e të gjitha sojeve
Ja mësynë famës së Juaj
Imituan dhe po imitojnë
Djajtë dhe të shenjtit
Me një degë ulliri
I bekuan fitoret e Juaja

Në emër të Atit dhe të lirisë
S'lënë gjë pa bërë mbi këtë tokë
Dhe sërish po veprojnë
Edhe më keq o Atë
Më duket se nuk dini të mallkoni
Ose nuk doni
Përse kështu o perëndi

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Nga dora e kujt nuk u dhunua
Kjo tokë e bekuar
Vranë fëmijë dhe nëna
Duke u dhënë gji foshnjave
Vranë e po vrasin identitetin tonë
Zgjohu o Atë
Zgjohu të përgjëron atdheu i sfilitur

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

ME POTKONJTË E VETËTIMAVE

E di nuk patët aç shumë kohë
Për ta njohur Zotin e juaj
Erdhët pas zërit të atdheut
U bëtë zot i tokave të dhunuara
Mbi këtë dhe
Pati vetëm një Skënderbe

Një kalë i egër
Me dekada hingëlloi
Hingëlloi prej fushës së Valkalisë
Deri te Malet e Mira
Atdheu ndjente dorën tënde
Merrte frymë si zanat e malit

Shiko se si jemi katandisur sot
O Gjergj i Madh
Mbi flokët e thinjura të atdheut
Po reshin shira të rreptë
Për një fjalë goje
Çohet peshë qivuri i vdekur

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Si në ëndërr mbrëmë i dëgjova
Hingëllimat e atdheut
Dikush i kishte mbathur kuajt
E egër të luftës
Me potkonjtë e vetëtimave
Prite me padurim zërin tënd urdhërues

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

ÇFARË NUK PASHË ATË DITË

I pashë të vdekurit
Të mbështjellë me batanije ushtarësh
Fëmijë të nakatosur
E nëna të përlotura
Me gjinj të prerë
Pashë vdekjen se si përpëlitej

Më tutje në kopsht
Në degët e dhunuara të pemëve
Tundej një flamur i grisur
Por jo edhe i dorëzuar
Kishte një krenari prej fluture
Si njeriu shikonte lindjen e diellit

I pashë edhe disa zogj
Të vrarë e të plagosur prej deltine
Njerëz që u ngjanin bishave
Egërsisht kafshonin njëri-tjetrin
Rrapi krenar shikonte diellin
Dhe i lëpinte plagët e atdheut

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Çfarë nuk pashë atë ditë
Në qytetin e vrarë të zambakëve
Pashë ushtarë të dehur
Që vritnin ushtarin më të afërm
Pash vdekjen me sy
Në sytë e çmendur të luftës

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

ARKIVOLET E MBUSHURA

Kjo muzikë e shthurur
Me qindra emra asnjanëse
I paska humbur taktet
Që në fillim të betejës

Lufta ka kohë që ka vdekur
Asnjë kurm nuk lëviz
Duken si kërcu të djegur
Në malin e kujtesës

Thërras e këlthas asnjë njeri
Nuk më dëgjon
Paska vdekur edhe njerëzia
Kjo luftë e pshurrtë i përdhosi varret

Asnjë kryq nuk paska mbetur në qytet
Arkivoleve të mbushur
Me nga disa njerëz
Që nga larg u dëgjohen gjëmat e trishtuara

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

NË VEND TË KOSOVËS

Më duket se asnjë kuptim më nuk kanë
Librat e shenjtë
Paskan vdekur edhe perënditë
Çdo gjë paska mbetur
Në duart e njerëzve
Zotat në këtë fshat ranë në provim

Por Prekazi nuk u dorëzua
Një Zot i ri po lind në tokën dardane
Po lind një dragua me shtatë kokë
Që u rri përballë
Djajve më të zi të Ferrit
Andaj me plotë gojë them Prekazi nuk ra

Nuk ra as atdheu im në dy gjunjë
Qëndroi po aq krenar
Sa mund të qëndrojë një popull dymijë vjet
Në vend të Kosovës
Si deveja e zgërlaqur ra Serbia
Ra në kokërr të shpinës murtaja e keqe

Cikli i dytë
Gjethi i këputur në vjeshtë

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

PEMËT I KISHTE NGRËNË MOLA

Isha në gjendje ta këlthas
Ose të pajtohem me vdekjen
Askush nuk ishte pranë meje
Desha ta kem një dëshmitar
Të ua tregoj botës
Por sojin e të pasojëve

Jashtë nëpër lagje
Dëgjoheshin vetëm lehjet e cerberëve
Njeri të gjallë
S'guxonte ta nxjerrë kokën përtej derës
Rafalët e plumbave
Kushtonin më pak se një jetë njeriu

Kë ta thërras në këto orë të liga
Jo për të më ndihmuar
Por për të dëshmuar
Një krim të paparë
Për fundin e një rruge
Që nuk i dihej as fillimi

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Ja pra përse isha në gjendje
Ta thërras vdekjen
Më shikonte vetëm druri i thatë
Pemët i kishte ngrënë mola
Kurse rrënjët gjëmonin pandërprerë
Në shpirtin e plagosur të mëmëdheut

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

KISHTE DALË DJEMURIA

Ishte një skamje e madhe
Mora dy gishta kripë
Pak bukë të mykur
Tok me pushkën e babait
Dhe me një këngë maje krahu
Dola në krye të fshatit
Ku veç kishte lindur
Një dritë inkandeshente

Te rrapi i cubave
Dielli vezullonte si një shpresë
E paarritshme
Kishte dalë djemuria
Ta përqafonte vdekjen ose lirinë
Kishte dalë njëherë e përgjithmonë
Me i dalë zot atdheut të sfilitur

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

TELAVE TË ARGJENDTA TË ERËS

Kur nëpër gjethet e gështenjës
Depërtojnë dritëzat e diellit
Bari gjethon si lisi
Gjethon dhe duket një mal i tërë
Në shuplakat e një bretkose

Dalin edhe gjinkallat mbi tokë
Këndojnë këngën e verës së kuqe
Sa që xhelozon Dionisi
Duke thithur ajrin e pastër
Hijet tulaten mes degëve

Zogjtë si në ndonjë shkollë muzike
Mësojnë të këndojnë
I bien për mrekulli
Telave të argjendta të erës
I bien derisa i zgjojnë këndesat mbi tra

NE JEMI MËSUAR ME PRITË

Përsëri do e përjetojmë
Bukurinë e vjeshtës
Do u shëmbëllejmë gjinkallave
S'do e ndalim këngën asnjëherë
Derisa i vjelim pjergullat

Sivjet kjo vjeshtë do u ngjaj nuseve
Me krahë të hapura
Do na pres te vreshtat
Do na pret derisa i vjelim kujtimet
Më pastaj le të fillojnë dasmat

Ne jemi mësuar me pritë
Pritëm me qindra vite lirinë
Andaj mos na ngacmoni
Kur përfundojnë të vjelat
Duhet t'i shkundim edhe mollët e pjekura

Prishtinë, 3 qershor 2017

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

SA QË GATI MBETA

Është natë e sterruar
Ende nuk po i shoh
Duart e gjetheve
Asnjë tunel nuk duket
Në fund të kësaj drite

Ju thashë se është natë
Nëpër rrugë nuk ka njerëz
Ku ta gjej një dëshmitarë
Të ju tregoj
Se si i ndeza mbrëmë yjet

Më besoni ishte një qetësi
E llahtarshme
Asnjë këndes nuk e zgjoi mëngjesin
Por të gjitha yjet
Ishin zgjuar dhe pritnin dorën time

Dhe ja arrita t'i kyçi edhe meteorët
Aq shumë dritë kishte në qiell
Sa që gati mbeta
Pa të dy dritat e syve të mi
Kur i kuptova se këndesat e zgjuan dritën

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

NJË ZANË E MIRË

Askush nuk më dëgjon
Kaloj nëpër gjumin e kristaltë
Të yjeve
Nata e kaltër me një bastun në dorë
I ndjek delet e qiellit nga kullosat

Një vrushkull shiu
Po ngritët në qiellin e paanë
Ky fenomen ndodh
Vetëm njëherë në njëmijë vjet
Por ja që ndodhi sivjet

Galaktika u largua për dymijë vjet drite
Dhe po për aq vite
Një hije e tejdukshme
U fundos në parzmën e tokës
Këto dukuri i tjerrë vetëm mendja e njeriut

Kurse yjet e përgjumura
Përkunden në djepin e artë të qiellit
Një zanë e mirë
Në çdo njëzetë e katër orë zgjohet
Dhe i mëkon yjet e sëmura me kujdes

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

SA QË EDHE KAMBANA E BRONZTË

Më duket se ishte një kohë
E pakohë
Kishat e përgjumura
I kishin shlyer emrat e murgjve
Më shumë se njëqind vjet
Asnjë psalm nuk dëgjuam te muranat

Më kuptoni çfarë po ju them
Koha nuk hante kashtë
Por koka njerëzish
Ndoshta ishte një kohë
Që as murgjit nuk donin të dinë për Zotin
Frika ishte më e tmerrshme se jeta

Dëgjoni çfarë po ju them
Ishte shumë e vërtet kjo formë
E frikës
Sa që edhe kambana e bronztë
Në kambanoren e vjetër të qytetit
E ndjente thellë tmerrin e tutës

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

DERI TE PORTAT E VDEKJES

Ende nuk munda të kuptoj
Se si një pasion im i panjohur
Rrinte në mendjen time
Dhe kah donte
E ku dëshironte me shtynte
Deri te portat e vdekjes

Në ato çaste vendimtare
E shihja fare mirë
Se si dukej vdekja
Në këmishën e saj të bardhë
Ishte diçka e tejdukshme
Sa që nuk kisha mundësi ta prekja

Më shikonte thellë në sy
Edhe unë shikoja si i babëzitur
Më duket se në disa momente
Frikohej nga unë
Zmbrapsej
Dhe sërish më sulmonte si e frikësuar

JANË SI ZOGJTË DELIKAT

Në çastin kur zgjohemi
Gjëja e parë është
Që ta fshehim ëndrrën
Mes ëndrrave të shkuara
Sepse druajmë të mos përsëriten

Më dëgjoni ëndrrat janë
Oh në çfarë nuk ngjajnë
Janë si zogjtë delikatë
Fluturojnë prej një ane
Në anën tjetër të mendjes

Depërtojnë thellë në gjumin tonë
Na i kontrollojnë të shtatë shqisat
Më pastaj ulen pranë nesh
Ulen për t'u larguar
Si hijet e zymta nga ndjesitë tona

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

GJETHI I KËPUTUR NË VJESHTË

Secili njeri e bën hapin e parë
Mu aty ku fillon vetmia
Me gishtin e vogël
I prek çastet delikate
Dhe udhëton nëpër qenien e guaskës

Kur del në breg nën sqetulla
E mban kujtesën e adoleshencës
Ulet pranë stolit të harruar
Shikon shkopin e vetmisë
Deri në mëngjes bisedon me të dashurën

Njeriu stoli dhe vetmia
Gjethi i këputur në vjeshtë
Dhe dy grushte shi
Që aq shumë dashurojnë heshtjen
Sa që shndërrohen në vetmi

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

NUK DI PËR KU JAM NISUR

Sa shumë i ngjaj sonte vetmisë
Me kë të bisedoj
Më ka harruar qyteti i zambakëve
Për kë të derdhi lot
Asnjë pikë uji nuk ka mbetur në sytë e mi

Edhe bastuni im i vjetër
Po ecën dy hapa para meje
Nuk kam as vend ku të ulem
Nga parku i qytetit
E paskan larguar stolin dhe ëndrrat e mia

Shikoj qiellin e mërrolur
Sa e thellë më duket sonte zbrazëtia
Asnjë yll s'shihet në hapësirë
Ky qiell lakuriq po i shëmbëllen
Këmishës sime të harruar

Nuk di për ku jam nisur
Dhe kur do të mbërri në shtëpinë time
Qyteti i vjetër shikon me xhelozi
Trastën e mbushur me letra
Dhe poezitë që po fundosen në mua

NUK LË XHADE PA SHKELUR

Ti domosdo duhet të kthehesh në atdhe
Diku në harresën tënde
Të pret fëmijëria e leckosur
Këmisha e arnuar me shtatë arna
Dhe pema e fatit
Ku i ushqeje zogjtë e fëmijërisë

Ka kohë që u largove
Ike diku larg nëpër metropole
Këpucët e harruara pas dere
Ende presin kthimin tënd
Të pret edhe një lejlek i lodhur
I cili kurrë nuk të takoi nëpër shtegtime

Nuk lë xhade pa shkelur
Fluturoi edhe përtej udhëve të jetës
Por askund nuk u takuat
Është koha e fundit të kthehesh
Të kthehesh biro
Ta rindërtosh çatinë e rrënuar prej stuhive

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

NË ENIGMËN E CILËS KËNGË

Kush po troket sonte kaq vonë
Në shpirtin tim të leckosur
Mos është zogu i fëmijërisë
Ose korbi i pleqërisë
Kush po troket sonte kaq vonë

Nuk di cilën derë ta hapi
Kur asnjëra nuk është e mbyllur
Kurse ti po troket në zbrazëti
Troket në kokën time
Me të trokiturat e mortit

Zërat e kujt po dëgjohen
Pas atyre maleve
Mos janë zgjuar vallë zanat
Në enigmën e cilës këngë
Paskan mbetur peng ushtat e thyera

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

NGRITËN VARRE MBI VARRET TONA

Trishtim pas trishtimi zogjtë kobzi
Nuk i ndalin krakëllimat
Nëpër qiellin e atdheut tim
Po ulërin ujkonjat
Po ulërinë mbi kurmin e një dhembjeje

Kush i theu duart e pemëve
Në kopshtin tim të fëmijërisë
E pastë mallkimin e hyjit dardan
Kurrë mos të shohin sytë e ti
Dritën e bardhë të diellit

Ky mallkim le t'i përcillet
Brez pas brezi
Askujt nuk i pata borxh
Që m'i nakatosën filizat e pemëve
Në vatrën e tyre mos pushoftë mallkimi

O Zoti im sa të ligj qenkan njerëzit
M'i thanë pemët në rrënjë
Prej ëndrrave të mia ndërtuan kala
Ngritën varre mbi varret tona
Kurrë mos pafshin dritë në shpirtrat e tyre

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

PO RINGJALLET KRUJA

Sa bukur këndonte rapsodi
Këndonte për ringjalljen e Krujës
Po lind një tjetër diell
Në hapësirën e robëruar të atdheut
Po lind një hënë e re

U zgjuan malet nga gjumi
E flakën përtej detit
Letargjinë e shpirtit
Po ringjallet Kruja
Për të parën herë po lindin perënditë

Olimpi shikonte me xhelozi
Lindjen e Zotave
Po zgjohen malet nga ëndrra e përdalë
Po lind një kohë e re
Në bedenat e lashta të Krujës po lind Kruja

Një hingëllim kali si zë kushtrimi
I zgjoi rrapet
Si kuçedra ngritën kokën muret
Kjo kështjellë më kurrë nuk dorëzohet
Për të parën herë po ringjallet Kruja

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

KUAJT TANI MË ISHIN DORËZUAR

Nuk dihet a thua vallë
Kishte filluar ose përfunduar lufta
Një re e madhe
E kishte mbuluar qytetin
Gratë me sy të trishtuara
Shikonin ka fundosej dielli në perëndim

Më duket se asgjë e re
Nuk kishte në horizontin e vrarë
Vetëm lehja e natës dëgjohej
S'pushonin as ulërimat
Nëpër majat e plepave
Nuk ndalej isoja e krakëllimave

Fushëbeteja rënkonte pandërprerë
Si një njeri i moshuar
Aty këtu dukej një flamur i grisur
Kuajt tani më ishin dorëzuar
Nga potkonjtë e thyera pikonte
Një lloj rrëshire për shërimin e plagëve

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

FËMIJËT I KISHIN LËNË PENG
ËNDRRAT

Kur bënë stuhi
Shkëmbinjtë ndjejnë thellë
Akordin e dallgëve
Diku në Jonin e trazuar
Qenka këputur dega e ullirit

Po ikin ose po kthehen zogjtë
Një re e ngarkuar me breshër
E ka mbuluar qytetin
Zambakët paskan mbetur pa ujë
Gjëma e kalasë dëgjohet përtej Drinit

Mbrëmë sa shumë pritëm
Kohën e shirave
Por asnjë pikë nuk kaloi nën Urën e Gurit
Te faltorja e Shën Mërisë
Fëmijët i kishin lënë peng ëndrrat

Kurrë më nuk u kthyen te kambana
Kryqi i vetmuar
Gati njëqind vjet priti
Priti ardhjen e një magjie
E cila s’ndodhi në tokën tonë

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

GJUMIN MË TË MIRË E BËNIM

Ishte koha kur i zbutshim kuajt
Nën pemët e egra
Prej fijeve të barit
I thurnim dizgjinët për të nesërmen
I thurnim
Edhe ëndrrat tona të bukura

Nuk na pengonte ftohti
As acari i ngrirë
Na u regj lëkura
Ngjante me lëkurën e kalit të egër
Nga rrënjët e manaferrave
Me një gjemb trëndafili shuanim etjen

Sa herë që kishim kohë
Gjumin më të mirë e bënin
Ne mesin e zambakëve
Ku me ne flinin edhe kuajt e zbutur
Pas zgjimit
Na pritnin luftëra të reja

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

PËRMBYTEN TË GJITHA DETET

Më duket se këta njerëz
Nuk dinë të qajnë
Kurse nga lotët e tyre
Përmbyten të gjitha detet
Është shumë i trishtueshëm
Vaji i shurdhmemecëve

Si një det i çmendur
Këlthet shpirti i tyre
Këlthet
E zë nuk qet
Belbëzon ajri i mykur
Nga thinjat e flokëve pikon dhembja

Por gjithsesi këta njerëz
Nuk ndalen
Vajtojnë si shirat
Ani që askush s'i dëgjon
Nga vaji i tyre
Përmbyten të gjitha detet e dynjasë

Prishtinë, 4 qershor 2017

PEMËT RRITEN KUDO

Mos thuaj asnjëherë
Se pemët nuk rriten këtu
Nëse thua
Dije se gënjen
Nuk të beson askush

Pemët rriten kudo
Edhe në syrin e kaltër të njeriut
Lëshojnë rrënjë nëpër ëndrra
Dhe trena të vjetër pa orar
Por gjithsesi rriten

Kur isha i ri kam parë
Se si rriteshin mbi çati të rrënuara
Rriteshin tok me hithrat
Sa shumë u ngjajnë njerëzve
Kur zbresin nga degët e thyera

TË THASHË SE TI JE NJË GRUA

Tani më ti je grua
Më tha se dikush jeton
Në mitrën tënde
Jeton një njeri i vogël
Shumë më i vogël se gishti tregues

Të thashë se ti je grua
Me një njeri në brendinë
Tënde hyjnore
Një njeri dhe një grua
Parakalojnë rrugëve të qytetit

Ti ecën në gjendje madhështore
Mburresh si një atkinë shale
Askush s'të del përpara
Me griva të mëndafshta
Fundosesh në shpirtin e erës

Të thashë e po të them
Se ti je një grua
Perëndeshë në shpirtin e së cilës
Rritet një pemë gjigante
Një krijesë që i shëmbëllen njeriut

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

T'I KYÇI TË GJITHA YJET E SHKYÇURA

Nuk di a thua vallë je ti
Ose duart e tua
Janë vetëm një pasion
Që i përvëlon rropullitë e mendjes
Kur të shoh
Sa shumë i ngjan yllit të mëngjesit

Njëqind herë të kam thënë
Dhe po të them sërish
Ti nuk je grua
Je një vullkan i pavdekshëm
Nga shpirti i të cilit
Burojnë zjarret e tërë botës

Edhe nëse shuhet përgjithmonë
Kjo dynja
Dhe vdesin drurët
E nëse mbetet vetëm në xixë
Afroma gjoksin tënd prej bjeshke
T'i kyçi të gjitha yjet e shkyçura

ATA QË MËKATOJNË

Nëse nuk kam se çfarë të bëjë tjetër
Përpos të arratisem
Ti mos më prit te portat e parajsës
Unë gjithsesi
Vendin e kam në ferr

Asnjëherë askujt s'i bëra asgjë
Mu për këtë
Më janë të hapura dyert e ferrit
Ata që mëkatojnë
Me kohë dinë t'i shlyejnë mëkatet e veta

Po të them mos më kërko askund
Vetëm në ferrin e jetës
Sërish do më gjesh
Me të gjitha mëkatet njerëzore
Dhe dashurit e mia hyjnore

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

NË LLAGËM RA HESHTJA

Në llagëm si vdekja
U shtri një pemë e madhe
Ca gjethe ranë në baltë
E balta e gjakosur
Dëgjonte krismën e shurdhtë të vdekjes

Shoku im me një gulçim
Të thellë
E përqafoi kondakun
Me sy të zgurdulluar shikonte dritën
E cila i errësohej në mendje

Nuk më tha asnjë fjalë
Ndoshta s'deshi të thoshte asgjë
Para disa ditëve më porositi
Nëse fiken dritat e yjeve
M'i bënë të fala atdheut

Në llagëm ra heshtja
U vra miku im ushtarë
Kurse në mua u zgjua bisha
Mitralozi vidhte vdekje
Vidhte në emër të atdheut dhe të shokut

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

PALLTOJA E VJETËR NË VARËSE

Çdo gjë e vogël në dhomën tonë
Një portret në miniaturë
Po ngre dolli
Për zvogëlimin e gjësendeve
Rafti i librave
Kurrë s'ishte më i vogël se sot

Palltoja e vjetër në varëse
Sapo kishte dalë e zvogëluar nga uji
Mënga e djathtë dukej qesharake
Si asnjëherë më parë
Në një pasqyrë konvekse
Varej në skutë një merimangë

Asnjë qiri nuk ndriçonte errësirën
E dhomës monotone
Shumë kohë
Ndoshta njëqind vite
Dora e njeriut s'i ka prekur orenditë
Sa duket statike kjo pamje surrealiste

ISHTE MËNGJES KUR IKU

Ishte një mëngjes i hershëm
Kur iku miku im
Në një gotë plastike
Para disa orëve
I kishte lënë protezat e dhëmbëve

Qiriu ende s'ishte shuar
Ndoshta bënte dritë
Për shpirtin e tij të lodhur
Po gjithsesi
Dukej një flakë e verdhë në shandan

Ishte mëngjes kur iku
Kështu kishte një zakon të çuditshëm
Çdo herë pa lindur dielli largohej diku
Dhe kthehej dikur vonë
Kur e ndjente lodhjen e ajrit

Por sot s'kthehet më dot
Iku duke e lënë qiriun e ndezur
Në një shandan të bronztë
Pasi të shuhet edhe flaka e fundit
S'do ketë më njeri për ta rindezur

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

PËR GJOKSIN E RRAPIT TË PLAGOSUR

Me nostalgji i përcjelli
Retë e lodhura
Pranë stolit në park
Nuk paska mbetur asnjë njeri
Ikën edhe zogjtë
Të pushojnë në çerdhen e natës

Vetëm kjo heshtje e shurdhët
Ma përkujton llagëmin
Ku më mbetën peng për një çast
Shqisat e të dëgjuarit
Ku vërejta
Dy gishta baltë të gjakosur në ballë

Askush në afërsi të kurmit tim
Dëgjove vetëm një krismë
Një eksplodim dhembjeje
Për herë të fundit
Retë qëndronin të mbështetur
Për gjoksin e rrapit të plagosur

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Asgjë më s’pashë e as s’dëgjova
Vetëm ndjeja thellë në mua
Frymëmarrjen e gjetheve
Një vijë e hollë uji
Ose gjaku
I prekte buzët e etura të një peme

Cikli i tretë
Mbrëmë vdiq për të tretën herë

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

THATËSIRA I KAFSHOI PEMËT

Si në një parakalim madhështor
Kalon vjeshta lakuriqe
Në duart e shitësit të gazetave
Një fotografi nudo
Duket si Afrodita në fron

Në tokën e djerrë
Kohë pas kohe lëshohen
Ca vrizma shiu
Dheu i etur si i çmendur
I gëlltit pikat e ujit të ngrohtë

Ky shi i vonshëm
E kjo stinë nuk janë në gjendje
Ta harmonizojnë kohën e të reshurave
Thatësira i kafshoi pemët
Asnjë fije bari për ta shuar urinë

Imazhet orë e çast ndryshojnë
Ky ekspresionizëm i paparë
I natyrës së vdekur
Është varur në murin e kujtesës
Dhe shikon me ironi ardhjen e dimrit

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

PUTHEN SI DY TË ÇMENDUR

Çdo gjë ka nga pak në dhomën time
Pak dimër pa acar
E pak shi me vrizma të tejdukshme
Jashtë në rrugë
Si dy statuja qëndrojnë dy të rinj

Era puthet me gjethet e njoma
Nën pemët e shkundura
Vjeshta i ka harruar pantallonat
Ai pak shi që bie
Nuk është në gjendje t'i laj sytë e vet

Pak flakë të verdhë lëshon
Vatra e vjetër
Në shandan ndizen shtatë qirinj
Shtatë lloj dritash lëvizin si oktopod
Në dhomën time të mbushur me gazeta

Ju thashë se dy statuja dhe vjeshta
Puthen si dy të çmendur
Nga jeleku i mëndafshtë i ditës
Rrëmbyeshëm rrodhën lumenjtë
Kur dy të rinj u puthën në vjeshtë

TË TRANSFORMOHESH NË PERËNDI

Ndonjëherë është mirë
Të jesh dikush tjetër
Një fyell prej drurit të manit
Ose okarinë
Nga deltina e atdheut

Është mirë të jesh një tjetër njeri
Nën këmishën tënde
Ose fizarmonikë
Në duart e ndonjë poeti endacakë
I cili i posedon gjenet e Panit

Thjesht të jesh dikush tjetër
E jo vetvetja e jote e bezdisshme
Të kalosh me një fjalor ndër sqetull
Ose me një gazetë të vjetër
Botuar para dhjetë dekadave

Ndoshta vetëm atëherë
Njerëzit dhe miqtë e tu të kuptojnë
Dhjetëfishin më mirë
Të jesh dikush tjetër do të thotë
Të transformohesh në perëndi

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

SYRI YT ËSHTË DIELLI QË KURRË NUK PERËNDON

Syri yt është një diell që shkëlqen
I cili askurrë nuk e përjetoi
Eklipsin
Është një botë lozonjare
Thikë me shtatë tehe
Kryqi i gozhduar në mur

Syri yt është hapësira e paanë
Ku përmbyten
Të gjitha anijet e humbura
Është peshku i artë
Në kepin i zjarrtë
Mbi mjegullat e purpurta

Syri yt është qielli
Kaltërsia e cila noton nëpër hapësirën
E paprekshme të shpirtit
Syri yt je ti
Moj zanë e Maleve të Mira
Syri yt është dielli që kurrë nuk perëndon

TI JE NJË KRIJESË

Ti je një kitarë
Njëmijë e një tela
Lindin në shpirtin tënd
Dhe sërish duken të nesërmen
Se asnjë tel nuk luante
Me flokët e tua të mëndafshta

Ti je një krijesë
Me njëmijë e një teke
Çdo mbrëmje i ndez qirinjtë
E tërë dynjasë
Për t'u bërë udhë perëndive
Deri te ëndrrat e tua të shthurura

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

QË TË DY MBETËM PENG

Ti i ndez qirinjtë
Unë i shkyçi zjarret
Hinorja mbi tavolinën e drunjtë
Luan valsin e mortit

Dy zjarre u ndezën mbrëmë
Ne qepallat e hënës
Nata lakuriqe
Gati se nuk vdiq nga xhelozia

Ti ishe përtej urës
Kurse unë këndej lumit
I ndizja zjarret
E ti i shkyçje të gjitha dritat e hënës

Që të dy mbetëm peng
Kokëfortësisë sonë
Nuk lëshuam pe
Derisa u këput lëmshi

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

ALFABETIN E FLUTURIMIT

Mos thuaj jo
Kur duhet të thuash po
Ama mos thuaj as po
Kur duhet të thuash jo

Mate shtatë herë një fjalë
Derisa e nxjerr nga goja
Përtype shtatë herë mendimin
Kur ma zgjatë dorën

Nga derri i egër
Mësoje ecjen mbi akull
Ose nga zogu i shenjtë
Alfabetin e fluturimit

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

ZHVISHET SI NJË NUSE

Stinët janë si njerëzit
Në çdo kohë
Imitojnë njëra- tjetrën
Pranvera asnjëherë nuk është pranverë
E as dimri dimër me acarë

Duken se u shëmbëllejnë vetvetes
Por rrinë aq larg
Sa që kurrë nuk takohen
Vetëm nëse ndryshojnë kohërat
Mund të ngjaj t'i prekin duart e pemëve

Vjeshta parakalon rrugëve
Si një nuse me barrë
I ngjyen buzët e lëngëta
Me të gjitha frytet e stinës

Kurse vera për çdo natë
Zhvishet si një nuse
Dhe në brigjet e Adriatikut
I imiton sirenat e kaltra të detit

PATRIARKU I FJALËS

Mes gishtave të dorës
E zgjoj Lumëbardhin
Drini krenar xhelozon
Te Guri i Hasit
Një gjel kryengritës
Errësirën e mohon

Këtu kishte dritë
Dhe gjithmonë do të ketë
Jemi në truallin
Ku perëndit e krijuan botën
Te Guri i Hasit
Ku lindi patriarku i fjalës

NA I DOGJËN EDHE KRYQET

Dimri nuk ishte këtu
Përse kaq acar
Në shpirtin e përdhosur të erës
Mbrëmë i dëgjuam krakëllimat
E mjegullave
Menduam se u shemb qielli

Ishte dyndja e hijeve të zeza
Dhe të kapelave sterrë
Nënat i mbyllën dyert e shtëpive
Por ecë e mbylle frikën
E cila si gjarpër
Flinte në shpirtin e secilit njeri

Kudo që shkelën hapën llagëme
Nuk lënë vend pa përdhosur
Për të dytën
Ose për të shtatën herë
Përsëritej vrasja e të vdekurve
Na i dogjën edhe kryqet për së gjalli

Prishtinë, 5 qershor 2017

MBRËMË VDIQ PËR TË TRETËN HERË

Në këtë humbëtirë
S'dëgjohet zëri i askujt
Vetëm pantomima paska zënë vend
Nëpër skutat shurdhmemece të dhomës
Pantomima e stërlashtë
Dhe një zambak i fishkur
Bisedojnë me zogjtë e fëmijërisë

Mbrëmë vdiqa për të tretën herë
Ishte një vdekje madhështore
Në përcjelljen e engjëjve
Ishe edhe ti
Me një zambak të bardhë
Të cilin e shkule
Nga krenaria e zemrës së Sharrit

Rrapet xhelozuan gjestit tënd intim
Xhelozuan deri në çmendi
Nata kishte veshur
Një këmishë të bardhë
Dhe dukej si mbretëresha në abdikim
Parakalonte si perëndeshë
Mes përmes kolonadave të kristalta

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

NDONJËHERË I HIPIM KALIT TË EGËR

Si zakonisht në pijetoren e lagjes
Për çdo mëngjes
Rrufisim kafen farmak
Dhe i shfletojmë gazetat
Para dy ose disa ditëve

Bisedojmë me figurat e shahut
Ndonjëherë i hipim kalit të egër
Dhe e nënçmojmë mbretëreshën
Pararojën e ushtarëve
Ja ndërsejmë mbretit idhnak

Me një kala prej balte
Mundohemi të ja gjejmë fundin dredhisë
Figurat herë na duken të gjalla
E herë të vdekura
Sa që pas kafesë nuk i varrosim

Mbesin vetëm si kurme të palëvizshme
Qëndrojnë mbi tavolinën e papastër
Si koçan lakre
Qëndrojnë deri të nesërmen
Kur me flamujt e grisur e rifillojmë betejën

LUMI IM I PËRGJUMUR

Tani më zëri yt më duket
Si një akord i largët
I cili buron
Nga një hon e llahtarshëm

Duart e tua dhe një zambak
Në sqepin e një zogu të bardhë
Fluturojnë në drejtim të erës
Fluturojnë deri sa e zgjojnë Lumëbardhin

Mes guralecëve të larmë
Ose gurëve të murrmë
Ripërsëritet ëndrra e myshqeve
Kurse algat vdesin nga heshtja

E lumi im i përgjumur
Pa ua prish akordin e tingujve të heshtjes
Për çdo mëngjes herët
Pa u zgjuar yjet udhëton deri te ëndrra e Jonit

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

PO IKIN VITET PO IKIN

Si hije të bronzta
Largohen vitet prej nesh
Na lënë peng ose amanet
Me nga një fije të thinjur flokësh
Që të kalben pas dymijë vitesh

Po ikin vitet
Po ikin
Pas hijeve të kristalta
Një pulëbardhë në kiçin e anijes
I numëron çastet memece të ikjeve

Deti i trazuar nga ëndrrat e meduzave
E lëshon spirancën
Deri në shpirtin e anijes së fundosur
Po ikin vitet po ikin
Pas pulëbardhave prej deltine

Çfarë na mbetet neve njerëzve
Kujtimi në pllakë mermeri
Ose kolonadat pa kryqe
Të ngulura
Thellë që ndërgjegjen e njeriut

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

PËR T'I VJELË KUJTIMET E VITEVE

Nuk di se kush do të vij sonte
Cila dorë do trokasë si shiu
Në xhamat e kujtesës
Është vjeshtë
Degët sapo nuk janë thyer

Ajo në dorë e mban kofinin
E shpresës
Vjen me një qëllim të vetme
Për t'i vjelë kujtimet e viteve
Troket në portat e hapura

Ju thashë se troket si e çmendur
Kjo erë e vonshme
Po i zgjon të gjitha ëndrrat
Një kofinë prej thuprave të thata
Në brendi i fsheh të gjitha stinët

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

NË KOR QANIN EDHE YJET

Hëna kishte ikur diku larg
Dukej si një kokërr pluhuri
Më duket se qante
Një klithmë vaji
Dëgjohej diku përtej mjegullave

Në kor qanin edhe yjet
Meteorët me bisht
Ngarendnin si pa kokë
Ishte një përzierje e madhe në galaktikë
Asnjë trup qiellor s'ishte në vendin e vet

Në amfiteatër ishin mbledhur perënditë
Pinin në emër të dashurisë
Vera njëmijë vjeçare
Derdhej nga leshrat e thinjura
Derdhej dhe thyheshin gotat e kristalta

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

SONTE S'DUA TË VDES I DUHEM ATDHEUT TIM

Asnjë yll nuk më duhet sonte
Më janë thinjur ëndrrat
Këtu poshtë ku jam pandërprerë
Dëgjoj zëra meteorësh
Gjëmat dhe klithmat e pemëve
Kurrsesi nuk dinë të mejnë

Mbrëmë frynte një fërfëllizë e acartë
Si gjethet e fishkura
Grimcoheshin shkëmbinjtë e stralltë
Nuk ishte fundi
Por s'ishte as fillimi i botës
Isha diku mes vdekjes dhe jetës

Krismat zgjatën aq shumë
Sa që u mësuam me britmat e shrapnelave
Në llagëmin e tretë
Disa herë e pashë vdekjen me sy
Iu zgërdhesha dhe i thashë troç
Sonte s'dua të vdes i duhem atdheut tim

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

QË LINDIN DHE VDESIN

Është e çuditshme
Vjeshta e piktorit ekspresionist
Në kallinjtë e misrit
Gatuan bukën e dashurisë
Dhe tërë ditën këndon një psalm
I cili këndohet njëherë
Në njëqind vjet

Më duket se në shpirtin e tij
Nuk ekziston dimri
S'ekziston as pranvera
Prej ngjyrave të diellit
Ose të ylberit
Krijon një tjetër stinë
E cila nuk i shëmbëllen asnjë stine

Sa herë që vjen vjeshta
Ai shndërrohet në një tjetër njeri
Dënes si kumria
Dhe këndon si gjinkalla
Kur i përjeton të gjitha ato ngjyra
Që lindin dhe vdesin
Në shpirtin e virgjër të vjeshtës

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

VAJTUAN ETËRIT VDEKJET E KUAJVE

Paskan vdekur zogjtë
As fluturat e kaltra
Nuk rrinë mbi degët e flokëve
Do e gjejmë rrugën deri te këngët tona
Po s'e gjetëm do shndërrohemi
Në statuja të verbëta

Dielli nuk i paska pjekur këto kolonada
Edhe gurtë qenkan të njomë
Nëpër cilën baladë
Kalëruan kalorësit e egër
Nuk paska mbetur asnjë shteg
Pa u shkelur nga potkonjtë e rrufeve

Mbi degët e mendjes sime
Një kohë të gjatë s'reshti së vajtuar
Një zog i zi nate
Vajtuan edhe shelgjishtet e pikëlluara
Betejën e sapo nisur të baladave
Vajtuan etërit vdekjet e kuajve

DY NUSE KTHEHESHIN NGA SPITALI

Në buzët e skuqura të Lumëbardhit
Era e lagëte sqepin e ditës
Dy të rinj adoleshent
Putheshin pranë Urës së Gurit

Afër një buste gati të rrënuar
Të një sistemi të egër
Me lot mallëngjimi qante një nënë
Qante për urrejtjen e mbjellë në Prizren

Dy guralecë të murrmë
U kishin hipur algave të verdha
Kalëronin nëpër fushat e Dukagjinit
Drini me krenari ledhatonte Gurin e Hasit

Dy nuse ktheheshin nga spitali
Me nga dy binjak në prehër
Kalldrëmet ilire pranë Shatërvanit
Shkëlqenin si asnjëherë më parë

Prishtinë, 6 qershor 2017

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Disa kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret, kryesisht me poezi, që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën "Pionieri" më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës dhe të pendës, themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në kuadër të punës së këtij grupi letrar, qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës, që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Muresha. Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë

1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 – 1995, nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe.
Jeton dhe krijon në Prishtinë.

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

BOTIME TË AUTORIT

1.“Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë,1974.

2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.

3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.

4.“Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997

5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000

6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007

7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007

8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007

9. “Udhëndarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008

1o“Thirrje e gjakut”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008

11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.

15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi, ”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010

22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot, 2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.
3o.“Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”’, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. “Zgjimi i gjëmës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtareve, Kastriot, 2010
33.“Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010

34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

35.“Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. “Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. “ Përtej teje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011

41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
44. “Mirëmëngjesi Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
5o. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot,2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012

61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013
79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
91.”Krakëllimat e natës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
94.”Psalm i harruar ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014

95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. “Stina asnjanëse”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
102. “Një grusht dashuri”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
105. “Si trenat e verbër ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” ,Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
116.”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi

Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2015
120. "Yjet e ngrira të kujtesës " , Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2015
121. " Thirrmat e hijeve", Poezi, Shtëpia Botuese"TREND", Prishtinë, 2015
122. "Dritaret e verbëta ", Poezi, Shtëpia Botuese"TREND", Prishtinë, 2015
123 . "Përtej portave të mbyllura" , Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2015
124. "Malli i etjes" Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
125. "Kur qajnë pemët ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
126. "Të dielave në qytetin tim ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
127. " Nëpër brigjet e kujtesës" Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
128. "Rrugës qante një stërqok", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
129. "Kali im prej bore" , Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
130. "Përballë hijes së mollës ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND ", Prishtinë, 2016
131. "Jehu i zërave", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
132. "Në kujtesën e pemëve ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND ", Prishtinë, 2016

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

133.“Më mirë një gjysmë ëndrre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016.
135.“ Në anën tjetër të mendjes”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
138. “Nuk i them uinë dot kësaj liri” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
139. “Fluturat prej letre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
14O. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
141.“Kumritë prej deltine”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2016

142.“Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017.
143.“Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
144.“Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017
145.“Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

146.“Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
147.“Një stinë delikate”, poezi,
Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
148.“Te ullishtat e vjetra ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
149.“Ishim të lumtur si gjinkallat”,
poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
150.“Pikëllimet e rrënjëve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
151.“Telat e shirave ” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017

NUK JANË BOTUAR ENDE!

152.“Një stuhi prej bryme”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2018
153.“Sonte s’ka dashuri ” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
154.“i shëmbëllente pluhurit kozmik”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2018
155.“Llamburite atdheu i plagosur” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
156.“Gurët e pjekura shtatë herë” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 20178

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

157. “Kur të dalë nga kjo stinë” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
158. “ishin thyer të gjitha urat ” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
159. “Gjethi i këputur në vjeshtë” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018

Përmbajtja :

Cikli i parë
Sonte do trokas deri në mëngjes

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Depërtoj nëpër rropulli mjegullash
Dënesin duart e kalbura
Si një makinë e përdorur
Prapë nuk dinte të ndalej
Dikur vonë lindi fjala
Të hy ose të dalë
Që shkon përtej metaforave
Sonte do të trokasim deri në mëngjes
Dëgjohej ajo valle e lashtë e etjes
Ashtu siç di vetëm jeta të merr frymë në luftë
Monologu i një luftëtari
Isha vetëm unë dhe frika
Kur edhe kryqin ma vodhën
U dorëzua kështjella
Pastaj ndodhi një luftë e madhe
Zgjohu o atë të thërret atdheu i sfilitur
Me potkonjtë e vetëtimave
Çfarë nuk pashë atë ditë
Arkivolet e mbushura
Në vend të Kosovës

Cikli i dytë
Gjethi i këputur në vjeshtë

Pemët i kishte ngrënë mola
Kishte dalë djemuria

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Telave të argjendta të erës
Ne jemi mësuar me pritë
Sa që gati mbeta
Një zanë e mirë
Sa që edhe kambana e bronztë
Deri te portat e vdekjes
Janë si zogjtë delikat
Gjethi i këputur në vjeshtë
Nuk di për ku jam nisur
Nuk lë xhade pa shkelur
Në enigmën e cilës këngë
Ngritën varre mbi varret tona
Po ringjallet Kruja
Kuajt tani ishin dorëzuar
Fëmijët i kishin lënë peng ëndrrat
Gjumin më të mirë e bënim
Përmbyten të gjitha detet
Pemët priten kudo
Të thashë se ti je një grua
T'i kyçi të gjitha yjet e shkyçura
Ata që mëkatojnë
Në llagëm ra heshtja
Palltoja e vjetër në varëse
Ishte mëngjes kur iku
Për gjoksin e rrapit të plagosur

Cikli i tretë

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë

Mbrëmë vdiq për të tretën herë

Thatësira i kafshoi pemët
Puthen sy dy të çmendur
Të transformohesh në perëndi
Syri yt është dielli që kurrë nuk perëndon
Ti je një krijues
Që të dy mbetëm peng
Alfabetin e fluturimit
Zhvishet si ndonjë nuse
Patriarku i fjalës
Na i dogjën edhe kryqet
Mbrëmë vdiq për të tretën herë
Ndonjëherë i hipim kalit të egër
Lumi im i përgjumur
Po ikin vitet po ikin
Për t'i vjelë kujtimet e viteve
Në kor qanin edhe yjet
Sonte s'dua të vdes i duhem atdheut tim
Që lindin dhe vdesin
Vajtuan etërit vdekjet e kuajve
Dy nuse ktheheshin nga spitali

A.Z.Gjethi i këputur në vjeshtë